

Pasqyrimi i Elementeve Kulturorë në Gjuhë dhe Ligjërim



Gjuhë dhe Kulturë

Fjalë kyçe: Kulturë, gjuhë, shoqëri, ndërveprim kulturor, shkëmbim kulturor, fushë tematiko-konceptore, etc.

Diana Djaloshi

Doctoral School, Institute of Language and Literature, Center of Albanological Studies, Tirana, Albania.

Abstract

Lidhjet dhe marrëdhëniet e gjuhës me kulturën janë bërë objekt i shumë studimeve të gjuhëtarëve të njohur. Si futet kultura në gjuhë si dhe si lidhet dhe ngjizet në gjuhësi, si fakt jashtëgjuhësor është bërë objekt i studimit të gjuhëtarëve dhe studiuesve të gjuhës dhe kulturës. Megjithatë nga studimet e bëra nga ky këndvështrim, në punimet gjuhësore- sociologjike më tepër ka dalë në fakt ana sociologjike, sesa ana gjuhësore. Marrëdhënia e gjuhës me kulturën, anën kulturore të shoqërisë dhe mendësitë duhet të trajtohet nëpërmjet pasqyrimit të elementeve kulturore të njësive gjuhësore (më tepër ligjërimore, meqë ato i përkasin edhe njësive më të gjëra se fjala) si psh: kulturë dhe kulturë shpirtërore, kulturë materiale që lidhen me kategorinë “kulturë”, jo vetëm nga pikëpamja fjalëformuese kulturë-kulturor-i kulturuar dhe togfjalëshformuese: *njeri i kulturuar, kulturë proletare, kulturë borgjeze*, por edhe nga ana e formimit të fushave tematiko-konceptore, si shtëpi kulture- vatër kulture- klub i grave që lidhen tematikisht me konceptin mjedis kulturor. Ndërveprimi kulturor dhe shkëmbimet kulturore kanë ndodhur në çdo periudhë dhe janë pasqyruar në gjuhë dhe ligjërim.

Probleme të konceptimit të fjalës “kulturë”

Lidhjet dhe marrëdhëniet e gjuhës me kulturën janë bërë objekt i shumë studimeve të gjuhëtarëve të njohur si të huaj Saphir dhe Whorf etj., ashtu edhe vendas si E. Çabej³⁰, Xh. Lloshi, Miço Samara etj. Si futet kultura në gjuhë si dhe si lidhet dhe ngjizet në gjuhësi, fakt jashtëgjuhësor është bërë objekt i studimit të gjuhëtarëve dhe studiuesve të gjuhës dhe kulturës. Megjithatë nga studimet e bëra nga ky këndvështrim, në punimet gjuhësore-sociologjike më tepër ka dalë në fakt ana sociologjike, sesa ana gjuhësore³¹.

Më shumë i është afruar anës gjuhësore të fakteve të kulturës Prof. Gjovalin Shkurta³² me punimet e tij ku janë nxjerrë faktet sociolinguistike nga lënda gjuhësore duke konsideruar parësore këtë të fundit. Marrëdhënia e gjuhës me kulturën, anën kulturore të shoqërisë dhe mendësitë duhet të trajtohen nëpërmjet pasqyrimit të elementeve kulturore të njësive gjuhësore (më tepër ligjërimore, meqë ato i përkasin edhe njësive më të gjëra se fjala) si psh: *kulturë dhe kulturë shpirtërore, kulturë materiale* që lidhen me kategorinë “kulturë”, jo vetëm nga pikëpamja fjalëformuese *kulturë-kulturor-i kulturuar* dhe togfjalëshformuese: *njeri i kulturuar, kulturë proletare, kulturë borgjeze*, por edhe nga ana e formimit të fushave tematiko-konceptore, si *shtëpi kulture- vatër kulture-klub i grave* që lidhen tematikisht me konceptin mjedis kulturor. Në këtë rast trajtohen edhe problemet e pasqyrimit e zbulimit të koncepteve që lidhen me kategorinë “kulturë” edhe në dy periudhat që bëjnë objekt studimi, si psh *vatër kulture*, si mjedis kulturor në periudhën moniste, sidomos në fshat (në fshatin socialist) dhe *klub i grave nga mjedis kulture* në shoqërinë pluraliste, ku gratë bëjnë debate të lira si të thuash rrëfihen për problemet e tyre.

Është e vështirë ta përkufizosh konceptin “kulturë” për të përcaktuar thelbin e kuptimit të saj, duke u përpjekur të identifikosh atë përmbajtje që ka të bëjë me të gjitha kuptimet. Megjithatë në mënyrë të përafërt kultura mund të konceptohet si veprimtari apo objekt veprimtarie me vlera të veçanta, të përzgjedhura e të ruajtura në kujtesën shoqërore e të regjistruara, të ekspozuara si modele të përhershme, karakteristike për një shoqëri që karakterizohet nga ana e zhvillimit fizik (kulturë fizike) materiale dhe shpirtërore. Në jetën e përditshme, me fjalën **kulturë** nënkuptohen aspekte të panumërta të jetës. Për pjesën më të madhe të

³⁰Çabej, E., “Elementetëgjuhësisë e tëliteraturëshqipe”, 1936

³¹McNair, B. shih 23, 44/1: KomunikimiNdërkulturor; 44/2: Instrumentet e Komunikimit; 44/3: Fuga A. “KomunikiminëShoqërinëMasive”

³²Shkurta, Gj., “Sociolinguistika”, shblu, Tiranë, 1996

antropologëve, **kultura** përfshin eksperiencat e përbashkëta, sjelljet e mësuara, besimet, pikëpamjet, vlerat³³, normat³⁴, qëndrimet³⁵, dhe idealet që janë karakteristika të një shoqërie apo popullate të caktuar. Në këtë kuptim, secili prej nesh është lindur në një kulturë komplekse, e cila ushtron një ndikim të madh gjatë gjithë jetës sonë. Gjithësesi brenda këtij përkufizimi ka tri elemente që pasqyrohen në tre togfjalësha ku si element i përcaktuar del fjala kulturë: *kulturë fizike, kulturë materiale dhe kulturë shpirtërore*, secila prej të cilave ka përkufizimin e vet, si edhe mund të ndahet në elemente të tjera që pasqyrohen në njësitë përkatëse ligjerimore, të cilat përbëjnë metagjuhën e “gjuhës” së kulturës si: *kulturë fizike popullore, kulturë sportive, kulturë fizike masive, kulturë biologjike, kulturë matematikore, kulturë inxhinierike, kulturë shpirtërore, kulturë shërbimi* etj.

Sistemi terminologjik, si metagjuhë e kulturës, bën që çdo togfjalësh të jetë i qëndrueshëm kur emërton një koncept me një term më vete: *kulturë botërore, kulturë borgjeze, kulturë socialiste, kulturë kombëtare; fakt i kulturës, element kulturor, përzgjedhje e fakteve kulturore, monument kulturore, format e kulturës, kulturë e shoqërisë, kulturë kolektive, vandalizëm kulturor*.

Si më poshtë po paraqesim një varg shembujsh nga fjalorët e ndryshëm të cilët tregojnë se si lidhet kultura me kuptimet e saj, me derivatet nëpërmjet marrëdhënieve të njësive gjuhësore njëfjalëshore dhe togfjalëshore:

Fjalori i Gjuhës Shqipe të vitit 1980 e shpjegon fjalën *kulturë* si:

1. Tërësia e arritjeve të një populli dhe të gjithë njerëzimit në fushën e prodhimit dhe në zhvillimin shoqëror e mendor; shkalla e këtyre arritjeve dhe e këtij zhvillimi në një etapë të caktuar; fusha e zhvillimit shoqëror në një etapë të caktuar; fusha e zhvillimit shoqëror që përfshin krijimtarinë e gjithanshme në gjuhë, në art, në letërsi, në shkencë dhe në tërë jetën shpirtërore: *kultura kombëtare, kultura shqiptare, kultura popullore, kultura e lashtë (mesjetare), kultura socialiste, thesari i kulturës botërore, zhvillimi i ekonomisë dhe kulturës*.
2. Shkalla e zhvillimit që ka arritur një popull një grup shoqëror a një njeri në një fushë të caktuar të veprimtarisë: *kulturë shendetësore, kulturë muzikore, kulturë gjuhësore*.
3. Tërësia e njohurive dhe e shprehive të sjelljes dhe edukatës që ka përvetësuar e përvetëson një njeri në shkollë ose në jetë: *njeri me kulturë, pallati i kulturës, vatra e kulturës, shtëpia e kulturës, Seksioni i Arsimit dhe i Kulturës, lëndë e kulturës së përgjithëshme* etj.

Fjala “Kulturë” lidhet si mikrosistem fjalëformues me një varg njësisish të formuara dhe që motivohen prej saj dhe paraqiten si më poshtë:

Kulturoj: v. latin. *Colere, lëroj, punoj, zhvilloj, rrit. I jap kulturë dikujt, e pajis me njohuri, me dituri dhe me edukatë të mirë, bëj që të kulturohet. Kulturoj rininë.*

Kulturor: -e. që ka të bëjë me kulturën e një populli a të një njeriu, që i përket kulturës, i kulturës; që i shërben kulturës, që bëhet në fushën e kulturës. *Niveli kulturor, jeta kulturore, punë kulturore, brigadë kulturore, revolucion kulturor.*

Kultivoj: fig. 4 kujdesem që të rrenjosem e të zhvillohet te dikush një ndjenjë, një ide, një mendim, një qëndrim etj, *kultivoj dashurinë për punën, kultivoj idetë e njeriut komunist.*

³³Vlerat janë elementi stabil i çdo kulture. Ato pasqyrojnë besimin e përgjithshëm që një mënyrë e caktuar sjelljeje ose udhëheqja në jetë nga disa parime të caktuara është personalisht ose shoqërisht më e preferueshme sesa një mënyrë tjetër sjelljeje ose udhëheqje nga parime të tjera. Vlerat kanë një lloj ngarkese morale dhe bartin idetë individuale të asaj që është e mirë, e drejtë ose e dëshirueshme.

³⁴Normat janë standarde sjelljesh që ekzistojnë brenda një grupi individësh/shoqërie.

³⁵Qëndrimet janë predispozicione të mësuara, për tu përgjigjur në mënyrë të qëndrueshme në favor ose disfavor të objekteve, njerëzve ose ngjarjeve. Ato përfaqësojnë mënyrën se si një individ ndihet përkundrejt diçkaje.

Kulturëdashës: -e. mb. Që është i etshëm për kulturë, që e do kulturën, që punon e ndihmon për zhvillimin dhe përhapjen e kulturës. *Atdhetarët kulturëdashës të Rilindjes.*

Kulturim -. Veprimi sipas kuptimit të foljes *kulturoj*. *Kulturimi i popullit.*

Kundërkulturë, a (lat. *Contra-kundër, cultura- kultivim, fisnikërim, gjerm. Kontrakulturë, fr. Contrakulture: ang. Contraculture*)- tërësia e vlerave, institucioneve, qendrave, orientimeve kulturore e sociale, të cilat, sipas mendimit të grupeve radikale- majtiste, duhet t'i kundërvihen *kulturës tregëtare, shtypëse* dhe, asaj *antihumane, borgjeze*. Kundërkultura, ashtu siç e interpretonin majtistët radikale në dekadën e gjashtë dhe të shtatë të shekullit XX, është shprehje e protestës dhe e refuzimit të kulturës borgjeze me synime përfitimi dhe me karakter shtypës.

I kulturuar: që ka fituar kulturë, që ka kulturë (*popull, sjellje, njeri*)

Në shumë gjuhë perendimore, *kulturë* do të thotë civilizim ose proces të menduari, rezultatet e së cilit përfshijnë edukimin, artin dhe literaturën. Më vonë nga fundi i shek. 18-të, në Gjermani e Angli termi *kulturë* shprehte edhe kuptime të reja me komplekse si: gjendje e zhvilluar e të menduarit, zhvillim i personit të kulturuar, arsimimin e artet, punën intelektuale, përgjithësimin e mënyrës së të jetuarit të një populli etj.

Fjala kulturë në gjuhë të ndryshme:

Gjuha burim	Anglisht	Polonisht	Rusisht	Spanjisht	Italisht	Gjermanisht	Norvegjisht
Latin <i>cultura</i> nga <i>colere</i> “të kultivosh”	culture	kultura	культура	cultura	cultura	kultur	kultur

Sipas “Fjalorit të termave, Shoqëria, Semiotika, Ekonomia, Kultura dhe Arsimi” të Ju. V. Rozhdestbenskij, termi kulturë shpjegohet si më poshtë:

Kulturë³⁶: Veprimtaria, që i shërben arritjes së qëndrueshme të produktivitetit të jetës së shoqërisë për sistematizimin, ruajtjen, mësimin dhe organizimin e rregullave dhe precedenteve të veprimtarisë.

Faktet kulturore: Rregulla dhe precedente nga jeta e shoqërisë që kanë kuptim për shoqërinë në të gjitha kohërat e ekzistencës së saj (dorëshkrime, libra, vepra arti, teknikë etj.)

Elementët e fakteve kulturore:

- Interpretimi i fakteve kulturore
- Sistematizimi i fakteve kulturore
- Ruajta, restaurimi dhe rindërtimi i fakteve kulturore
- Kulturënjohja
- Sistemet informuese

Format e kulturës

a. *Kulturë fizike*

- Kulturë fizike popullore
- Kulturë fizike antike
- Kulturë fizike e Mesjetës
- Sporti
- Kulturë fizike e kohës moderne

³⁶Ju. V. Rozhdestbenskij, “*Slovar Terminov*”, Flinta, Nauka, 2007/59

- Kulturë masive fizike
- b. *Kultura materiale*
 - Kulturë materiale bioteknike
 - Kulturë materiale inxhinierike
 - Kulturë materiale shërbyese (posta, telegraf, radio, telefon, telekomunikacion)-teknologjia
- c. *Kultura shpirtërore*

Llojet e kulturës

- Kultura e shoqërisë
- Kultura e kolektivit
- Kultura e individit

Llojet historike të transmetimit të kulturës

- Komunikimi gojor
- Komunikimi i shkruar
- Komunikimi i shtypur
- Komunikimi elektronik

Emërtimet që lidhen në përmbajtje tematiko- konceptore me kategorinë “kulturë”

1. Emërtime që i përkasin objekteve inorganikë (tokë, arë, plantacion)
 - a) Kultivoj tokën (*arën, plantacionin*)
 - b) Kultivoj bimët (*grurë, misër, fruta*)
2. Emërtime që lidhen me bimë (*grurë, bishtaja, mollë*)
3. Emërtime që lidhen me kafshë (gjallesa): *peshk, midhje, fruta deti, karkaleca.*
4. Emërtime që lidhen me ndjesi njerëzore (*dashuri, urrejtje*)
5. Emërtime objektsh ruajtëse (*bibliotekë, muze*)
6. Emërtime informuese – argëtuese (*internet, telefon*)
7. Emërtime argëtuese (*spektakle, shfaqje, lokale, klube*)
8. Emërtime ekspozitash, promovimesh (*këndi i kuq, gazetë muri*)
9. Emërtime institucionesh mësimore edukuese (*shkollë, universitet*)
10. Emërtime veprimtarish (*sport, gjimnastikë, atletikë*)
11. Emërtime mjedisesh (*shtëpi kulture, vatër kulture, pallat kulture* etj)
12. Emërtime për objekte historike për njohjen e zhvillimeve në historinë e vendit, realizimet më të spikatura (*prodhimi, vepra arti, vepra ndërtimi*)
13. Emërtime këngësh, vallesh, lojërash (*valle dyshe myzeqare, kala dibrançe, kaba me klarinetë*)

Faktet e kulturës në dinamikën e pasqyrit në komunikimin fjalësor

Kultura e kohës së monizmit fitoi karakteristikat e *kulturës strikte*³⁷. *Kultura e proletariatit* rezultoi në një mbingarkesë ideologjike në fushat e shkencës dhe të edukimit. Çdo gjë progresive konsiderohej si mënyrë të menduarit të proletariatit dhe çdo gjë perendimore shihej si ide reaksionare. Në atë kohë nuk kishte një ide që mund të asociohej me qënien njerëzore përtej përkatësisë klasore. Njerëzit ishin të ndarë në dy grupe të mëdha *njerëzit tanë, njerëzit e rinj* dhe *armiqtë tanë* (të brendshëm dhe të jashtëm). Gjuha e ideologjizuar e monizmit apo siç e quan Prof. Fuga “*stalinizëm linguistik*³⁸” e “*depersonalizon*” përdoruesin e fjalës dhe e ruan fjalën në

³⁷Geert &Gert Hofstede, "Cultures and Organizations: Software of the Mind" The McGraw-Hili Companies, 2005

³⁸Fuga, A., “Komunikiminëshoqërinëmasive”, Papirus/308

formën e verdiktit gjuhësor, të detyrueshëm për të gjithë. Konteksti në gjuhën e re (novojaz) merr shumë më pak vlerë dhe njësitë gjuhësore janë të klishëzuara dhe të ngurtësuara në rendin e tyre. Mendësia e asaj periudhe kishte të bënte më shumë me “*qartësinë e kuptimit të fjalëve dhe njësitë të tjera gjuhësore*” sipas modelit stalinian dhe ishte pjesë e procesit të ngurtësimit të procesit të menduarit, kontekstit dhe perceptimeve të përdoruesve të gjuhës. Duke përsëritur shumë shpesh të njëjtën njësi dhe duke kuptuar në mënyrë të detyruar dhe të imponuar të njëjtën gjë, konteksti del pothuajse jashtë rolit të vet.

Në këtë kontekst në monizëm kemi dukurinë e politizimit të konceptit “kulturë”: ndarja në *kulturë borgjeze dhe kulturë proletare* më vonë në *kulturë borgjeze dhe kulturë socialiste*. Në monizëm janë politizuar të tëra kulturat, që kufizoheshin brenda konceptimit klasor: *Kultura politike* e monizmit është pasqyruar në shumë thënie klishe si psh: “*proletarë të të gjitha vendeve bashkohuri*” apo togfjalësha *familje proletare, shpirt proletar* etj.

Fjala *kulturë* përdoret në mënyrë të mendësuar për të përshkruar një fushë të caktuar të veprimtarisë si psh: *Kulturë shëndetësore, kulturë muzikore, kulturë gjuhësore, kulturë e artit pamor, kulturë mjedisore, kulturë e të folurit* etj. Mënyra e përdorimit të fjalës *kulturë* në këto togfjalësha mund të mendësohet përderisa e shprehur në kohë të ndryshme, nga individë të ndryshëm apo nga shtresa të ndryshme shpreh mendësi të ndryshme. Psh togfjalëshi: *kulturë mjedisore* sot përshkruan mendësinë e individëve që përqipen të mbrojnë mjedisin nga shkatërrimi, promovojnë ruajtjen e mjedisit dhe madje e shohin mjedisin si një ndër faktorët kryesorë që siguron qëndrueshmërinë dhe ruajtjen e burimeve për brezat e ardhshëm. Kjo shihet kur përdorim shprehje të tilla si: *edukimi mjedisor, edukimi i qëndrueshëm mjedisor, ambasadorë të mjedisit* etj.

Gjatë periudhës së monizmit togfjalëshi *kulturë mjedisore*, shprehte mendësi krejt të ndryshme nga sot të shprehura me njësitë gjuhësore: *punë vullnetare, mbjellje pemesh, aksion me goditje të përqendruar, të dielat e Enverit* etj. Në atë kohë mbrojtja e mjedisit kishte më tepër të bënte me ndërjegjësim të njerëzve për të pastruar vullnetarisht dhe në mënyrë të organizuar ambientet rreth pallateve dhe ambientet e përbashkëta. Ata që e kanë jetuar atë periudhë kujtojnë mbjelljet masive të pemëve në dhjetor apo edhe *aksione me goditje të përqendruar* për të pastruar. Në periudhën e monizmit çdo gjë riciklohej ndërsa sot togfjalëshi *kultura e riciklimit* përshkruan një proces që promovohet por që nuk zbatohet. *Kultura e riciklimit* është shumë e mangët. Po kështu *kultura shëndetësore* është përdorur edhe gjatë periudhës së monizmit edhe sot. Në periudhën e monizmit *kultura shëndetësore* kishte të bënte me mësimin e popullatës se si mbrohej shëndeti dhe kishte karakter ideologjik dhe politik. Sot me *kulturë shëndetësore* lidhen edhe fjalë dhe togfjalësha të rinj që përshkruajnë dukuri të reja si: *edukimi i rinisë, mbrojtje nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme, përdorimi i drogës dhe alkolit, lufta për të parandaluar SIDEN, Gripi i shpendeve/ derrat, Ebola* etj. Lindja e sëmundjeve të reja ka sjellë njësi të reja që nuk përdoreshin më parë.

Të njëjtat njësi gjuhësore, të përdorura në të dya periudhat që janë në fokusin e këtij punimi, shprehin mendësi të ndryshme si psh:

Njeri me kulturë (në monizëm): një njeri që di shumë për artet dhe muzikën dhe që ka lexuar shumë libra (në sfondin ideologjik): ka lexuar libra të realizmit socialist, dëgjon muzikë dhe pëlqen artin e shoqërisë socialiste me përbërje klasore.

Njeri me kulture (në pluralizëm): njeri që lexon shumë, njeh artin dhe muzikën, ka njohuri mbi kulturat e tjera. Shpesh i referohemi një njeriu që sillet mirë, njeh rregullat qytetare dhe të edukatës, flet me zë të ulët dhe nuk përdor dialekt etj. Përdorimi i mendësuar ka të bëjë me përshkrimin si njeri me kulturë të dikujt që demonstroi cilësitë që renditen më lart.

Fjala *kulturë* si element i përcaktuar është prodhimtare e shumë togfjalëshave dhe në periudhën e monizmit është përdorur në mënyrë të mendësuar ideologjikisht dhe politikisht: *Kulturë kombëtare, kulturë*

shqiptare, kulturë popullore, kulturë e lashtë, kulturë socialiste, njeri me kulturë, vatra e kulturës, shtëpia e kulturës, Seksioni i Arsimit dhe Kulturës etj. Togfjalëshat e krijuar me elementin e përcaktuar “kulturor” në monizëm shprehin mendësi ideologjike dhe politike. “*Revolucion Kulturor*” në monizëm lidhet me procesin famëkeq të kopjuar nga kinezët “*Revolucioni kulturor*” ku nën emrin e kulturës u bënë shumë spastrime dhe luftë klasore; *Trashëgimia kulturore, jeta kulturore (shumë aktive), puna kulturore* (sipas kulturueshmërisë së masave dhe puna me popullin në lidhje me edukimin me kulturën socialiste), *marrëveshje kulturore, gjendja kulturore, bashkëpunimi kulturor, niveli kulturor (i lartë)*, të gjithë përshkruajnë procese të mendësiuara ideologjikisht. Në pluralizëm përdorën të njëjtët togfjalësha por me kuptimin e tyre real dhe jashtë kornizës ideologjike.

Elementi përcaktues i/e “kulturuar” formon togfjalësha të shumtë dhe përshkruajnë mendësi në lidhje me diçka që duhet të bëhet sipas rregullave të sjelljes dhe të edukatës së mirë: të qenit i kulturuar ishte tipar i njeriut të qytetëruar: *pushim i kulturuar, çlodhje e kulturuar, shërbim i kulturuar, jetë e kulturuar* etj.

Lidhja e fjalës kulturë në rrethin e fushave/mikrofushave tematiko-konceptore: *Kulturë- civilizim- edukim- edukate- sjellje- formim- dije*

Lidhjet në rrafshin sintagmatik me bazë foljen: *Folje + kulturë: rrezaton kulturë, tregon kulturë, fiton kulturë, transmeton kulturë*

Lidhjet në rrafshin sintagmatik togfjalëshor me bazë emrin kulturë si element i përcaktuar:

Emër + mbiemër:

- a) Mbiemër si fjalë e përgjithshme: *kulturë e lartë, kulturë e ulët, kulturë e gjërë, kulturë e përgjithshme.*
- b) Elementi përcaktues emër asnjans: *kulturë e të folurit, kulturë e të shkruarit, kulturë e të menduarit.*
- c) Mbiemër si fjalë librore: *kulturë kombëtare, kulturë moderne, kulturë borgjeze, kulturë proletare, kulturë mondane, kulturë europiane etc.*
- d) Fjala kulturë si element përcaktues: *shtëpi kulture, vatër kulture*
- e) Me fjalën e lidhur në mikrosistem fjalëformues me kulturë
i kulturuar: njeri i kulturuar, mjedis i kulturuar, jetë e kulturuar
- f) Me parafjalë + emër në togfjalëshat: *njeri me kulturë, njeri pa kulturë, sjellje pa kulturë, veprim pa kulturë* etj.

Përdorimi në formë të kundërvënë nxjerr në pah mendësimin e fjalës kulturë. Kundërvënia realizohet në disa mënyra (në sjellje, në veshje, në ligjerim, në mënyrën e jetesës): *kulturë fashiste/ kulturë marksiste, kulturë proletare/ kulturë borgjeze, kulturë qyteti/ kulturë fshati*. Kultura asociohet po ashtu me fjaleve: *varfër / e pasur/ e lartë / e ulët* duke formuar togfjalëshat që kundërvihen me njëri tjetrin: *Kulturë e varfër/ kulturë e pasur, kulturë e ulët/ kulturë e lartë*;

Etiketimet për njerëzit “pa kulturë” lidhen me: a) Padijen: fshatar (naiv), katundar; b) Veprime: *çeqen (flet me zë të lartë), malok (sillet pa edukatë)*; c) Vlerësime negative: *i paedukatë, i pakulturuar, i pazhvilluar, i paditur*; d) Vlerësime pozitive: *i edukuar, i sjellshëm, erudit, i shumëanshëm, i lexuar, i shëtitur* etj.

Siç u tha edhe më lart mendësitë e njerëzve në lidhje me konceptin e kulturës ndryshojnë në periudhën e monizmit dhe të pluralizmit: Nëse dikush (në monizëm) do të thoshte: *-Erdhi kultura*, bashkëbiseduesi do ta kuptonte si një njeri që njih shumë gjuhë të huaja, ka njohuri në shumë fusha dhe flet bukur. Por nëse dikush etiketohet si *borgjez* dhe reflekton kulturë të veshuri, të foluri si borgjezet atëherë: *- Erdhi kultura*, do të kishte

kuptim mendësior negativ dhe nëse bashkëbiseduesi kishte të njëjtin perceptim në mendjen e vet për individin në fjalë, do të kuptonte të njëjtën gjë si dhe folësi.

Kuptimet që njerëzit kanë për fjalët përcaktohen nga kultura ku ata janë rritur. Studimet e bëra kanë provuar se gjatë pjesës më të madhe të historisë së shoqërisë njerëzore, kultura është transmetuar nëpërmjet komunikimit personal të njerëzve. Njerëzit brenda të njëjtës kulturë ndajnë të njëjtat *vlera, qëndrime*, të kuptuar dhe kjo i bën të ngjashëm në mënyren se si i përceptojnë dukuritë dhe objektet e reja si dhe mënyrën se si reagojnë ndaj objekteve dhe dukurive egzistuese. Siç e theksuam edhe më lart fjala kulturë ka kuptim të gjërë. Shembull përbën se si ka ndryshuar emërtimi i mjedisit për nevoja publike (sot *tualet*): Pothuajse deri më sot përdoret kryesisht në fshat fjala *hale* (me theks në é si në turqishte) si variant edhe *hale* (si përdorimi *s'bie rrufeja në hale*) *erdhi ai* (haleja).

Paralel me të pas vitit 1944 përdoret *nevojto* (formim para vitit 1944). Jo vetëm në fshat, por edhe në qytet, ku ekzistonin edhe në qytete për përdorim publik. Pas zhvillimit të vendit (*ekonomikisht, kulturorisht*, meqënëse dy fjalët e mësipërme krijojnë asociacione të këqija) u fut në vitet 1960 në përdorim nga anglishtja i shkruar me shkurtesa *WC*. Ky shkurtime shkruhej edhe në banjot publike në qytete. Kjo maskonte diku anën e keqe të objektit. Pas kësaj u përdor për në lokale në qytete banjë (banjo) dhe *banjo popullore* dhe më vonë *banjë popullore*. Banjo përdoret edhe për lokale individuale. Me zhvillimin e sotëm kryesisht pas viteve 1990 u zhduken *banjot* në mjediset jashtë dhe u futën brenda lokaleve. Meqënëse ishte përdorim i brendshëm, pranë vendit ku shërbehej (pihej kafeja, hahej ushqim) atëherë u fut fjala *tualet*. Kjo fjalë e fshihte shumë objektin nga konotacioni negativ. Fjala *tualet* krijon asociacione të shumta edhe pozitive si psh. “bën tualet” (zbukurohet).

Dinamika: *håle-halé - nevojto*-*WC-banjo- tualet*;

Kjo dinamikë edhe në gjuhën angleze dhe në gjuhë të tjera ku sot përdoret *tualet* (ang. *Lavatory- WC- toilet*).

Ndikimi e ndërveprimi kulturor



Skema nr. 1. Ndikimi dhe ndërveprimi kulturor

Ndërveprimi kulturor dhe shkëmbimet kulturore kanë ndodhur në çdo periudhë dhe janë pasqyruar në gjuhë dhe ligjërim. Siç e kemi thënë më lart gjuha e pasqyron realitetin dhe është domethënia e ndërveprimeve njerëzore (Sonntag³⁹ 2003). Në ditët e sotme procesi i shkëmbimeve kulturore po ndodh me intensitet shumë të lartë dhe njësitë e reja që emërtojnë ndryshimet në shoqëri kanë vlerën e një ditari, libri historie, që përshkruan në mënyrë të tërthortë ngjarjet politike, sociale, ekonomike, kulturore në historinë e një komuniteti apo të një shoqërie të tërë. Meqënëse në ditët e sotme shumica e hyrjeve të njësisve gjuhësore të reja në gjuhët e botës vijnë nga gjuha angleze, studiuesit kanë zhvilluar një terminologji të pasur për të përshkruar këtë proces. Në studimet politike termi “*globalizim gjuhësor*” është përdorur kryesisht për të emërtuar dukurinë e përhapjes së gjuhës angleze, mjet komunikimi global (Phillipson⁴⁰, 1992; Dua⁴¹, 1994) në formën kryesisht të huazimeve të njësisve gjuhësore të gjuhës angleze nga gjuhët pritëse. Ditët e sotme termi tradicional *internacionalizma* (për leksikon me origjinë Greke apo Latine) përdorën së paku nga tre grupe gjuhësore të familjes Indo- Europiane (Mścienwicz⁴², 1993) si psh: *president, kulture, politics, bank, analysis, planet*, film, doctor etj., është vjetëruar dhe zëvendësuar me termin *globalizma* (Bartimiski⁴³, 2000:116) për të përshkruar hyrjen e njësisve të reja gjuhësore (kryesisht nga gjuha angleze) në një numër shumë të madh gjuhësh të tjera për të emërtuar dukuritë dhe objektet e reja si edhe për shkak të teknologjisë së re.

Shumica e *globalizmave* kanë gjuhën angleze si gjuhë burim. *Globalizmat* që nuk vijnë nga gjuha angleze quhen ndryshe edhe *huazime kulturore*, terma specifike kulturore që emërtojnë dukuri tipike për një shoqëri dhe traditat e saj zakonore, historike, fetare, politike si psh. *Ayatollah* (nga arabishtja) apo *perestroika* dhe *glasnost* (nga gjuha ruse), *burrëreshat* (nga shqipja), *domestic* (nga rusishtja) etj. Globalizmat kanë depërtuar me intensitet të lartë pothuajse në të gjitha gjuhët e botës emërtojnë avancimet teknologjike amerikane ose modelet kulturore amerikane. Në këtë rast mund të flasim për “*amerikanizim të kulturës botërore*” (Huntington⁴⁴, 1996) që në shumë raste studiues të ndryshëm i referohen si “*imperializëm gjuhësor*” (cf. Tomlinson^{45,46}, 1991; 1999, Phillipson⁴⁷, 1992:65), apo “*Hegjemonia e gjuhës angleze*” (Phillipson⁴⁸, 1992, Dua, 1994; Sontag^{49,50}, 2003). Shprehje të caktuara gjuhësore kodojnë eksperiencë shoqërore, theksojnë pikëpamje të caktuara, dhe në të njëjtën kohë ndikojnë mbi përdoruesit e gjuhës të adaptojnë këto pikëpamje. Shembull përbën shprehja “*njeriu i ri*” për periudhën e monizmit ku theksohet pikëpamja komuniste në lidhje me tiparet, mënyrën e jetesës dhe të sjelljes, qëndrimet dhe pritshmëritë e partisë dhe shoqërisë për “*njeriun e ri*”. Sapo kjo shprehje filloi të përdoret për herë të parë në Bashkimin Sovjetik u huazua nga gjuha shqipe dhe filloi të përdoret në fillim nga udhëheqja e partisë dhe pastaj në mënyrë masive nga e gjithë shoqëria. Njësitë gjuhësore që përdorehin fillimisht nga udhëheqja e partisë apo udhëheqësi i partisë kishin një ndikim të menjëhershëm mbi përdoruesit, të cilët i bënë të vetat këto shprehje me shumë natyrshmëri dhe i përdornin deri në ngulitje në një afat të shkurtër kohor. Ishin pikërisht këto njësi gjuhësore që formuan modele të shprehjeve klishe që ndikuan tek përdoruesit në mënyrën e tyre të mendimit dhe të perceptimit të tyre. Kuptimi i njëjtë nga përdoruesit krijoi atë *ndërgjegje kolektive* apo *kulturën e njeriut të ri*, e cila në kontekstin e këtij punimi, mund të quhet mendësia kolektive e monizmit (e ideologjizuar, e politizuar, e klishezuar dhe e ngjyrosur emocionalisht).

³⁹ Sonntag, S.K., 2003. *The Local Politics of Global English: Case Studies in Linguistic Globalization*. Lanham, MD: Lexington Books.

⁴⁰ Phillipson, R., 1992. *Linguistic Imperialism*, Oxford.

⁴¹ Dua, H.R., 1994. *Hegemony of English*, Mysore

⁴² Maćkiewicz, J., 1993. wyrazymiedzynarodowe (internacionalizmy) we współczesnymjęzykupolskim”, in: J. Bartmiński (Ed.), *Encyklopedia kultury polskiej XX wieku. Tom II. Współczesnyjęzyk polski*, Wrocław (pp. 525-531).

⁴³ Bartmiński, J., 2000. „Pasywne i aktywne paneuropeizmy we współczesnymjęzykupolskim”, in: J. Mazur (Ed.), *Słownictwo współczesnej polszczyzny w okresie przemian*, Lublin (pp. 109-116).

⁴⁴ Huntington, S.P., 1996. *The Clash of Civilizations*, New York

⁴⁵ Tomlinson, J., 1991. *Cultural Imperialism*, Baltimore.

⁴⁶ Tomlinson, J., 1991. *Shih* 58

⁴⁷ Phillipson, R., 1992. *Linguistic Imperialism*, Oxford.

⁴⁸ Phillipson, R., 1992. *Shih* 60

⁴⁹ Sonntag, S.K., 2003. *The Local Politics of Global English: Case Studies in Linguistic Globalization*. Lanham, MD: Lexington Books.

⁵⁰ Sonntag, S.K., 2004. “*Hegemony and Resistance: Linguistic Globalization in the Early 20th Century*”, Paper presented at the annual meeting of the American Political Science Association, Hilton Chicago and the Palmer House Hilton, Chicago, IL, Sep 02, 2004

Është pikërisht leksiku i përdorur dhe sidomos njësitë kyçe apo bosht që shihet si reflektim i të ashtuquajturit “sensor kulturor” të zakoneve, traditave, vlerave dhe mënyrës së mendimit të shoqërive të caktuara (Wierzbicka⁵¹, 1998). Këto njësi nxjerrin në pah jo vetëm karakteristikat e një kulture të caktuar, por sqarojnë edhe ndryshimet midis kulturave. “Njësitë kyçe” apo “njësitë e leksikut të kushtëzuara nga kultura” (Tabakowska,⁵² 2001:185) të zhvilluara dhe të ngulitura historikisht janë pasqyrim të kulturës specifike që përcaktojnë kulturën e një shoqërie të caktuar si psh: Guru (në kulturën dhe traditën Hindu) garat, race në Amerikë, ayatollah në kulturën dhe shoqëritë islame, besa, kanuni apo burrëreshat (në kulturën dhe traditën shqiptare). Shumë shprehje të tjera si psh ground zero (niveli zero) i referohen ngjarjeve politike dhe historike që lidhen drejtpërsëdrejti me historinë e një kombi; shembuj të tjerë përbëjnë: Water gate, shembja e Murit të Berlinit, Revolucioni i Kadifenjtë Çekoslovak, Vrasja e Çaushekut, Revolucioni Portokalli (në Ukrainë), Pranvere Arabe, Komunitetit European, Pavarësia e Kosovës etj. Fjalët kyçe të një gjuhe emërtojnë vlerat kyçe të zhvilluara dhe të ndara nga njerëzit që e flasin gjuhën si psh.: luftë klasash, njeriu i ri, diktaturë e proletariatit etj (monizëm) dhe demokraci, ekonomi tregu, globalizimetj (në pluralizëm). Ato janë kyçe për një kulturë të një kombi për ata që kanë dëshirë ta kuptojnë një kulturë të caktuar (Wierzbicka, 1998). Si rjedhje e lidhjes së ngushtë që theksuam më lart nuk mund të ketë ndryshime në gjuhë pa patur ndryshime kulturore që ndodhin paraprakisht. Dukuria e transferimit kulturor ndodh nga ndryshimet politike, sociale dhe ekonomike të një vendi që mban statusin e superfuqisë (kulturore, teknologjike, politike, ekonomike dhe shoqërore).

Ndikimet gjuhësore që shkaktojnë shkëmbime kulturore janë dy llojesh: **-fjalë** a togfjalësha (loanwords) / njësi gjuhësore të huazuara: iPod, iPhone, talk show, top channel, top story, top select, X-Factor, milestones, etj., identifikohesh me shumë lehtësi sepse janë shumë të ngjashme fonetiki dhe frafiki me gjuhën burim (anglishten); **-fjalë të përkthyer** (loan translations) kalke të modeleve të anglishtes: qiellgërvishëse (sky scraper), (feedback) informacion i kthyeshëm, qëndrueshmëri (sustainability), stakeholders (pretendent) etj. Shumë nga këto fjalë janë “huazime kulturore” sipas (Bloomfield⁵³, 1993) ose shprehje që përfaqësojnë fusha të veçanta semantike si: teknologjinë kompjuterike, biznesin, ekonominë, politikën, po kështu edhe kulturën popullore, kozmetikën apo modën.

English	Spanjisht	Rusisht	Gjermanisht	Polonisht	Hungarisht	Turqisht
iPod	iPod	ай-Под iPod	iPod	iPod	iPod	iPod
fast food	fast food (comida rápida)	фастфуд	fast food	fast food	gyorsételek	fast food
Talk show	Talk show	Talk show	Talk show	Talk show	Talk show	Talk show
Halloween	Halloween (Noche de Brujas)	хеллоуин	Halloween	Halloween	Halloween	cadılar bayramı

Tabela nr. 2 Shembuj huazimesh

Më pak të dukshme janë huazimet e përkthyer si psh rat race (gara e minjve), First Lady (Zonja e Parë), ground zero (Niveli zero) , head hunter (gjueti truri), skyscraper (qiell gërvishëse), fat-free (pa yndyrë), white collar (kollaret e bardha), Silicon Valley (lugina e silikonit), Trojan Horse (në kuptimin kompjuterik),

⁵¹ Phillipson, R., 1992. *Shih 60*

⁵² Tabakowska, E., 2001. *Kognitywnepodstawyjęzykajęzykoznowstwa*. Kraków Whorf, B.L.,

1956. *Language, Thought and Reality: Selected writings of Benjamin Lee whorf*, Ed. J.B. Carroll. New York.

⁵³ Bloomfield, L., 1933. *Language*, New York.

brain drain (rrjedhja e trurit), dream factory (fabrika e ëndrrës), Star Wars (luftat e yjeve), popular culture (kulturë popullore), middle class (klasa e mesme), positive thinking (të menduarit pozitiv) etj.

Bashkëveprimi i gjuhëve është proces i integruar me procesin e bashkëveprimit kulturor. Sikurse thotë Mishel Fuko, fjalët janë prerje që çdo kulturë e madhe bën mbi fluksin ligjërues që prodhohet nga shoqëria. Raportin e gjuhës shqipe me gjuhët e tjera dhe sidomos të hyrjes së njësive të reja gjuhësore në përdorim sidomos pas viteve 1990, e ka trajtuar hollësisht edhe Prof. Artan Fuga në librin e tij “*Komunikimi në shoqërinë masive*”. Në këtë libër përshkruhen dukuritë e përdorimit të pa kriter të fjalëve të huaja, sidomos nga të rinjtë, të cilët i përdorin ato herë në mënyrë vulgare, herë pa ua ditur fare kuptimin ose edhe rastesisht në vend të fjalëve dhe të njësive të gjuhës shqipe vetëm për *vanitet*⁵⁴ apo për *modë*. Po kështu përmenden politikanët, apo figura të tjera publike, të cilët për të fituar vemendje përdorin fjalë të huaja jashtë kontekstit dhe shpesh pa ua ditur as vetë kuptimin. Por autori kritikon qëndrimin e pajustificuar të disa akademikëve, të cilët ndonjëherë me histerizëm përpiqen të mbrojnë “pastërtinë e gjuhës shqipe” duke qënë kundër të gjitha hyrjeve të huaja në një mënyrë *donkishoteske* dhe pa racionalizëm duke penguar pasurimin e gjuhës tonë me fjalë dhe njësi gjuhësore të reja, që pasqyrojnë ndryshimet e vullshme në të gjithë sektorët e jetës së shoqërisë tonë dhe jo vetëm të shoqërisë tonë, por në të gjithë botën. Autori pohon që shqipja e ditëve të sotme po “*amerikanizohet*⁵⁵”, “*greqizohet*” apo “*gjermanizohet*”. Shumë të huaj amerikanë që jetojnë dhe punojnë në Shqipëri flasin me humor për “*shqiplish*⁵⁶” që është edhe mënyra se si ata komunikojnë më shqiptarët duke përdorur fjalë nga të dya gjuhët.

Por ky proces nuk sjell domosdoshmërisht vetëm pasoja negative. Leksiku dhe kuptimi i tij po pasurohet dhe forcohet dhe për rrjedhojë gjuha shqipe po shndërrohet në gjuhë bashkëkohore. Autori argumenton me të drejtë që një shoqëri e hapur pasqyrohet në një gjuhë të hapur, e cila pasurohet në mënyrë dinamike. Hyrjet e mëdha të njësive gjuhësore të huazuara nga gjuhët e tjera kanë bërë të mundur emërtimin e dukurive dhe objekteve të reja për realitetin shqiptar, për të cilat gjuha shqipe nuk ka kapacitetin e duhur për t’i emërtuar. Ky është një proces që po e drejton gjuhën drejt pasurimit dhe kultivimit të saj. Gjithësesi kjo hyrje masive e fjalëve të huaja dhe për më tepër e një mënyrë tjetër të menduarit ka krijuar probleme. Në këtë kontekst një problem i rëndësishëm dhe i pazgjidhur për momentin mbeten librat e përkthyer nga literature e huaj dhe sidomos të teksteve universitare janë të paqarta, konfuze, të palexueshme dhe të pakuptueshme, për shkak të pamjaftueshmërisë së njësive adekuate të shqipes për të emërtuar dukuritë dhe konceptet e reja, të mungesës së reflektimit të mënyrës kulturore shqiptare të të menduarit si dhe të mosnjohjes së mirë të gjuhës nga ana e përkthyesve.

“Ndërkohë që nëpërmjet makromarketingut përsëri synohet rrjedhja e të mirave e shërbimeve nga prodhuesi tek konsumatori me qëllim plotësimin e nevojave konsumatore, theksi i tij tashmë nuk është me aktiviteti i organizatave individuale”⁵⁷.

Disa përpjekje të bëra deri tani për të zëvendësuar fjalë të huaja me fjalë (neologjizma) të gjuhës shqipe kanë rezultuar të dështuara në shumë raste si psh: *doracak*⁵⁸, *dyrrotak*⁵⁹ (është përdorur që para vitit 1990) për të zëvendësuar fjalët manual dhe *biçikletë* apo *motorçikletë*. Këto fjalë të reja nuk janë gjetur nga përdoruesit me

⁵⁴Vanitet (Vanity)

⁵⁵Fuga, A., Shih 51

⁵⁶Djaloshi, D., Article,

⁵⁷Hyrjenë Teorinë e Marketingut (Tekst për Studentet)

⁵⁸Fuga, A., “*Komunikimi në shoqërinë masive*”, Papirus/306

⁵⁹Fuga, A., Shih 51

vlere shprehëse dhe përdoruese dhe madje janë konsideruar si pa shije⁶⁰ dhe deri vulgare dhe për këtë arsye asnjëherë nuk morën vlerë përdorimi.

Një tjetër përpjekje është bërë për të gjetur emërtime gjegjëse në shqipe për konceptet *stakeholders*, *feedback*, *milestones* etj, duke i zëvendësuar me fjalët shqipe: *pretendent/aktor* (stakeholders), *informacion i kthyeshëm* (feedback) dhe *gur kilometrazhi* (milestones). Këto njësi nuk kanë mundur të nguliten nga përdoruesit, sepse ato nuk shprehin dhe nuk kanë arritur të emërtojnë në mënyrën e duhur konceptin dhe për këtë arsye përdoruesit kanë preferuar të përdorin fjalën, siç përdorët nga gjuha burim ose t'a adaptojnë atë sipas rregullave morfologjike të gjuhës shqipe si në rastet: *fidbek*, *slajd*, *imejl* etj.

Prof. Fuga flet po ashtu për një “*krizë lingvistiko- semantike*”: përdorimi për të njëjtën përmbajtje kuptimore të fjalëve të ndryshme apo e njëjta fjalë në kontekste të ndryshme merr kuptime të ndryshme. Kjo situatë sipas tij ka sjellë një “*kaos konceptual*”⁶¹ dhe pasqyrimi i tij në gjuhë dhe ligjërime krijon probleme të mëdha për përdoruesit e gjuhës.

Fakti që brenda gjuhës shqipe po krijohet një “*fond leksikor i huaj*”⁶² është i dukshëm dhe duhet të bëhet objekt i studimeve të shumta. Bernard Henri Levi ka thënë që “pastërtia e gjuhës” është e rrezikshme, sepse ajo mund t'i “vrasë” gjuhët. Gjuha e ideologjizuar e monizmit apo siç e quan Prof. Fuga “*stalinizëm lingvistik*” e “*depersonalizon*” përdoruesin e fjalës dhe e ruan fjalën në formën e verdiktit gjuhësor, të detyrueshëm për të gjithë. Konteksti në gjuhën e re (novojaz) merr shumë më pak vlerë dhe njësitë gjuhësore janë të klishezuar dhe të ngurtësuara në rendin e tyre. Mendësia e asaj periudhe kishte të bënte më shumë me “*qartësinë e kuptimit të fjalëve dhe njësitë të tjera gjuhësore*” sipas modelit stalinian dhe ishte pjesë e procesit të ngurtësimit të procesit të menduarit, kontekstit dhe perceptimeve të përdoruesve të gjuhës. Duke përsëritur shumë shpesh të njëjtën njësi dhe duke kuptuar në mënyrë të detyruar dhe të imponuar të njëjtën gjë, konteksti del pothuajse *jashtë rolit të vet*.

Këto shprehje kur futen në kulturën përkatëse marrin vlera shtesë të kulturës lokale ku përdoren si psh. *rrjedhja e trurit* e marrë nga origjinali *brain drain* ka ndryshuar nga *tharje në rrjedhje* (eksodi i madh i viteve 1990 ku pati ikje masive të intelektualëve) dhe mënyra e perceptimit në kontekstin kulturor shqiptar ndryshon nga origjinali, sepse në këtë rast hyrjet e reja në njësitë gjuhësore bazohen në ngjarjet historike përkatëse siç thotë Harley⁶³ “*historia e kuptimit të pothuajse çdo fjale, është një histori e vogël kulturore*”. Në shumë raste njësi e huazuar merr një ngjyresë të re kulturore si në rastin “*analfabet funksional*” (functionally illiterate). Ky togfjalësh është po ashtu një hyrje e re në ligjërime dhe ka filluar të përdoret nga elitat që dallohen për *sqimë dhe elegancë në të folur*. Në realitetin kulturor shqiptar historia kulturore e “*analfabetit funksional*” lidhet me lëvizjen demografike të pakontrolluar të popullsisë pas vitit 1991 nga zonat rurale në Tiranë. *Analfabetët funksionalë* (përqindje e vogël e të ardhurve), të cilët edhe pse dinin shkrim dhe këndim e patën shumë të vështirë të integroheshin me jetën në qytetin e madh, të zhvillonin shprehitë dhe aftësitë e duhura për vende pune në agjensi shtetërore apo private, të sillen në mënyrë qytetare dhe të bashkëjetojnë në komunitet të madh. Edhe pse një huazim kjo hyrje e re është bërë pjesë e mendësive tona kulturore dhe ka një histori të vetën kulturore. Për këtë arsye *huamarrja dhe huadhënia ndërgjuhësore* nuk është thjeshtë një çështje gjuhësore. Kjo është një dukuri sociale dhe kulturore.

Në rrafshin e mendësive të caktuara mund të vështrohen edhe një shumësi njësisish leksiko ligjërimore që kanë pasuruar lidhjet tematiko-konceptore të kategorive “kulturë”, të futura në shqip në periudhën pastotalitare

⁶⁰Fuga, A., Shih 51

⁶¹Fuga, A., Shih 51

⁶²Fuga, A., Shih 51

⁶³ Harley, “*English Words*”, Blackeell Publishing, 2006: 102).

Sapir, E., “*Selected Writings in Language, Culture and Personality*”, ed. D. Mandelbaum, Berkeley, 1949.

qysh prej vitit 1991, të panjohura për shoqërinë tonë si *dixhej (DJ), karaoke, rep, diskoklub, diskoteke, bikini, porno, homoseksual, transeksual, lesbike, depilim, sauna* etj. Ndonjëra prej tyre ndihet edhe si një pasurim e sidomos diferencim i koncepteve të kaluara moniste, që disa vijnë të emërohen: sot *parti*, dikur *mbrëmje vallëzimi*, sot *lokal* dikur (në vitet 1992-1995) *diskoteke, diskoklub, para viteve 1990 (klub)*, sot *dixhej*, dikur *orkester*, sot *homoseksual* dikur nuk njiheshin termat respektues dhe përdorshin vetëm termat fyes si *pederast, dylberetj*. Këto fakte kanë të bëjnë me mendësitë e reja për mënyrën e jetesës, sjelljen, veshjen, pasqyrimin e jetës në spektakle e shfaqje si *Big Brother, talent show, X Factor, Voice of Albania* të pasqyruara me fjalë të huaja. Vlerë të veçantë merr trajtimi i konceptit “kulturë” në anën përmbajtësore në vetvete, që e bën më të lehtë shqyrtimin e saj të mëtejshëm në lidhjet fjalëformuese e togfjalëshformuese (si *kulturë- kulturor- kulturim- kulturëdashës -sjellje kulturore*) si edhe në lidhjet tematiko- konceptore, lidhjet në bazë të asociacioneve të krijuara mbi bazën e tërësive që lidhen në sistem me fjalën “kulturë”.

Në mënyrë të përmbledhur mund të paraqesim shumë aspekte të kulturës amerikane që janë adaptuar nga kultura shqiptare si dhe kulturat e tjera të pasqyruara në njësitë gjuhësore:

1. Stili i punës, bërja e karrierës nëpërmjet konkurrencës: *mjedis konkurues, CV, përshkrim pune, punë me orë të zgjatura, part time* (me kohë të pjesëshme), *full time* (me kohë të plotë); procese zyrtare *headhunter* (gjuetia e trurit), *trajnim në punë* (on the job training/coaching), *orientim* (orientation), *periudhë prove* (probation period) etj.
2. Emrat e pozicioneve të punës: *Menaxher (i lartë, i mesëm), Menaxher Programi/ Projekti, CEO (Chief Executive Officer) Zyrtar i Lartë i Ekzekutivit, Specialist i Burimeve Njerëzore, Asistent Logjistike, Kordinator Sigurie, Kordinator i Ndërveprimet Kulturor, etj.*
3. Teknologjia moderne e komunikimit dhe e gjithë terminologjia e kompjuterit: *çat, çatist, çatis, haker, bukfaiz (bookface), postoj, follower (follower).*
4. Ushqimi dhe zakonet e të ushqyerit (*ushqyerja e shëndetshme, fast food, kaloritë, djegja e kalorive* etj)
5. Kultura popullore (filmat, muzika, TV, argetimi) shembuj muzika: *pop, rock, hip hop, rep, repist, house, techno, R n'B.*
6. Fjalë që emërtojnë koncepte apo dukuri të reja për shoqërinë shqiptare: *bikini, tanga, pirsing, depilim.*
7. Fjalë që emërtojnë veshje: *xhinse “boyfriend”, mom's jeans, xhinse bust, pantollona tub, tanga braziliane* etj.
8. Reklammat (metaforat dhe shprehjet reklamative: *ata që keni nevojë janë vetëm një telefonatë larg (reklamë e kompanisë celulare), humbni peshë në tre ditë, komuniteti numër një në Shqipëri (vodafon), pranverë në trupin tuaj (për ujin)*
9. Përdorimi i eufemizmave⁶⁴⁶⁵ për të shmangur emërtimin e gjërave në mënyrë direkte: kur nuk kemi kaluar një ditë të mirë themi: *kam patur edhe ditë më të mira, kam qënë edhe më mirë*, në vend që të themi për një person “*gënjeshhtar*” themi “*i pasaktë*”, “*jo i përpiktë*”, në vend që të themi “*i çmendur*” përdorim termin “*me aftësi të kufizuara mendore*”, në vend të themi “*vdiq*” themi “*u nda nga ne, e humbëm, na la*” etj.
10. Përdorimi i parashtesave *hiper, mega, super* sidomos në media për të prezantuar ngjarje të shënuara dhe për t'a bërë informacionin më të besueshëm: *megavjedhje, super heronj, super yll, super vjedhje, super vendim, super zhvillim, super maxhorance*. Shpesh ndodh që njësia “super” mëvetësohet në përdorim si psh “*është super*” etj.

⁶⁴ Leka, F., “FjaloriTermave të Letërsisë”, Infbotues:137

⁶⁵ Eufemizma quhen zakonisht gjithë ato fjale e shprehje, qe zëvendësojnë fjale te vrazhda e te pahijshme me fjale e shprehje me te lehta e me te buta. Tek eufemizmi ndryshohet forma e shprehjes pa u ndryshuar asgjë nga përmbajtja e saj. Praktikimi i shprehjeve te lehta për dukuri te renda e te egra ka qene rrjedhoje e pafuqisë se njeriut ndaj forcave shkatërruese te natyrës, kur natyra sundonte pothuajse për çdo gjë mbi njeriun. Njeriu me fjale i merrte me te mire fuqitë e fshehta e te egra te natyrës. Eufemizëm (mat)- shprehje e mirë (angl) euphemism. Figurë që krijohet kur përdorim fjalë a fraza të pëlqyeshme, të hijshme, dashamirëse, për të shënuar sende e dukur që në të vërtetë janë të papëlqyeshme, të papërshtatshme apo të lodhshme.

Kultura amerikane dhe anglishtja janë identifikuar shpesh si “*pushtuesit e kulturës globale dhe homogjenizimit global*” (Sonntag⁶⁶, 2009:8). Në këtë kontekst mund t’i referoheshim tre njësive gjuhësore të huazuara nga gjuha angleze që emërtojnë tre procese të ndryshme:

Shplarje truri (brainwash) në **monizëm** (*larje truri, kontroll i procesit të të menduarit, ideologjizim i të menduarit*); ky proces në kulturën e shoqërisë shqiptare perceptohet si “shplarje” dhe jo “larje”.

Kompani rekrutimi (Headhunting): është një njësi aktive vetëm në periudhën e 5 viteve të fundit në Shqipëri. Ka një analogji me “*gjuajtjen e trurit*”, pra me përzgjedhjen e profesionistëve, që plotësojnë kriteret për një punë të caktuar në organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë rast kompanitë quhen “*headhunting*” dhe nuk kanë gjetur fjalë apo njësi gjegjëse në shqipe.

Kulture globaliste që i përket gjithë njerëzimit e pasqyruar në njësitë: *dashuria për jeten, dashuria për njeriun, nevoja për të punuar, nevoja për t’u lidhur me të tjerët.*

Rrymat globale kulturore gjithmonë kanë patur ndikim (impakt) në shoqëritë e ndryshme dhe kanë kërkuar përthithje të tyre rezultati i të cilave mund të konsiderohet si hibrid për shkak të përshtatjes në mënyrë krijuese me “elementet kulturore lokale” (Osterhammel & Petterson⁶⁷, 2005). Gjuhët pritëse dhe kulturat pritëse ndikojnë mbi hyrjet e reja në mënyrë dinamike (duke u veshur hyrjeve ngjyresa të reja kuptimore). *Shok* në kuptimin e përdorur gjatë luftës pas vitit 1944 deri në 1990 sipas rusishtes. Si formim i përdorur përgjithësisht nën ndikimin e gjuhëve të huaja, të përdorura si psh: rusisht *komunisti*. Por në rusishte vetëm si formë *shok* (tovarishç) si për seksin mashkull ashtu edhe për seksin femër *tovarishç Ivan* dhe *tovarishç Ana*. Ndërsa në shqipe kemi *shok dhe shoqe*, pra kemi diferencim gjinor: *shoku Sekretar* dhe *Shoqja Drita*. Në periudhën moniste fjalët *shok dhe shoqe* jo vetëm që kishin ngjyrim mendësior në lidhje me konsiderimin e tyre *tanët* dhe jo *të atyre* (që ishin zonja dhe zotërinj) por edhe në përdorimin e tyre për të shprehur mirësjellje dhe për të zëvendësuar *gra dhe burra* që dukej sikur merrte karakter vulgar po të përdorej në këtë mënyrë. Në ditët e sotme fjala *shok* në përdorimin e vet politik dhe të ngjyrosur nuk përdoret më në të njëjtën mënyrë. Rastet e përdorimit janë vetëm në rastet e ngjyrimin negativ për të theksuar se një shok i përket partisë socialiste dhe që ka prejardhje komuniste. Nëse themi *shoqja Vilma* referimi është për një femër që është pjesëtare e partisë socialiste, dhe që ka një pozitë të lartë në të, por nuk ka imazh të mirë (kur i drejtohet dikush nga partia demokratike).

Në këtë kontekst mund të flasim për përdorimin në mënyrë të mendësuar të fjalëve: *kooperativist* dhe *kooperativiste* (me krenari). Fjala *kooperative* është fjalë e me prejardhje të huaj. Sipas fjalorit të vitit 1980, *Kooperative*: 1. *Ekonomi kolektive socialiste, e krijuar nga bashkimi vullnetar i punonjësve të një fshati a të disa fshatrave, të cilët kanë bashkuar tokat dhe mjetet e tjera kryesore, të prodhimit, punojnë së bashku dhe i ndajnë të ardhurat sipas sasisë dhe cilësisë së punës që kryejnë, kooperative e tipit të lartë*; 2. *Formë kolektive socialiste e organizimit të punës në sferën e prodhimit: kooperative artizanati*. Siç shihet një pjesë e shpjegimit që jep fjalori është e ideologjizuar dhe e mendësuar ndërkohë që pjesa tjetër është përcaktim real i konceptit “*kooperative*”. Fjala *fletërrufe* ka prejardhje kuptimore nga realiteti kinez *dacibao* madje ndodhte që dikush ti referohej fletërrufesë si *dacibao* dhe kishte të kuptuar të plotë se për çfarë bëhej fjalë.

*Tufëz*_fjalori i vitit 1980: *tufëzoj*: Bashkoj bagëtinë, e mbledh në tufë të përbashkët: *kooperativistët tufëzuan delet*. Fjala *tufëz* në kuptimin e bagëtive të bashkuara vullnetarisht nuk ekziston në fjalorin e vitit 1980.

⁶⁶ Sonntag, S.K., 2009. “Linguistic globalisation and the call center industry: Imperialism, hegemony or cosmopolitanism?”, *Language Policy* (2009) 8: 5-25.


⁶⁷Sonntag, S.K., 2009. Shih 77

Arëz _ fjalori i vitit 1980: kjo fjalë nuk ekziston në fjalorin e vitit 1980 edhe pse në të folurën politike madje edhe të përditshme të asaj kohe përdorej shumë. Edhe pse *tufëz* dhe *arëz* u shndërruan në koncepte komuniste të kohës ato përsëri nuk u pasqyruan në fjalor.

Fjala *burrneshë* është një fjalë që nuk ekziston në asnjë gjuhë tjetër të botës fjalori i vitit 1980: e shpjegon si “*vajzë a grua trime, e zonja dhe e patundur, që përballon çdo rrezik e vështirësi me guxim: qëndron si burrëreshë*. Kjo fjalë dhe shpjegimi që i jep fjalori tregojnë për natyrën maskiliste të shoqërisë, e cila e sheh gruan me tipare burrërore kur flitet për trimeri, përballje të vështirësive. Gruaja duhet të jetë *burrëreshë* për të qënë *e patundur* sepse nëse s’është *burrëreshë* mund të *tundej* apo *tundohej*. Komunizmi e *zhveshi* gruan nga feminiteti duke e quajtur bukurinë dhe feminitetin dobësi. Sot fjala *burrneshë* përdoret për të përshkruar një vajzë të pamartuar që pranon të *burrërohet* dhe të mbajë rolin e djalit të shtëpisë në rastet kur familja s’ka djalë apo kur familja s’ka baba. Ky është gjithësesi një koncept që përshkruan një dukuri që ka pushuar së ekzistuari.

Përshtatja sipas normave morfologjike të shqipës si dhe kombëtarizimi i fjalëve të huaja do të jenë rrugët e pasurimit dhe të kultivimit të gjuhës shqipe.

Skema 2: Qarkullimi i elementeve kulturore



Rrethi i jashtëm- Kultura përfaqësuese globale (e një vendi të madh: amerikan, anglez)

Rrethi i mesëm – Kulturë shqiptare nga prurjet; fondi ndërkulturor

Rrethi i brendshëm – Kulture tërësore shqiptare, fondi tërësor, vetjak (originale dhe prurjet nga kulturat e tjera)

Prerjet e huaja:

Në monizëm: Dukuritë kulturore të huaja (*perendimor, amerikan*) ishin të ndaluara nga regjimi, por ato depërtonin në kohëra të ndryshme, sidomos kur kishte shënja të liberalizimit: kujtojmë periudhën e Festivalit të XI të pasqyruara në njësitë gjuhësore: *minifund, pantollona kauboj, qafëlesh, fund zving* etj.

Këto njësi gjuhësore pasqyrojnë dukuritë që njiheshin si “*shfaqje të huaja*” në pamjen e njerëzve dhe ishin të dënueshme nga shoqëria dhe sidomos nga *partia*. Por kundërvënia e vlerave të kulturës së asaj kohe ka të bëjë me faktin se “*shfaqjet e huaja*” në veshje dhe muzikë dënoheshin nga *partia*, por pëlqeshin nga rinia (në mënyrë të fshehtë). Ky është një fakt kulturor i rëndësishëm, sepse elementët e kulturave të tjera arritën të depërtonin edhe shoqërinë tonë që ishte një shoqëri tërësisht e mbyllur. Shfaqjet e huaja pasqyroheshin në:

Veshje: *fund zving, pantollona kauboj, minifund, maksifund, maksi, mini* (shumë nga këto njësi përdorën edhe sot edhe pse parametrat e emërimit të njësisë ndryshojnë: psh tjetër kuptohej me “*mini*” gjatë periudhës së monizmit, dhe tjetër kuptohet sot).

Muzikë/Kërcim: *twist, çaçaçça, mambo, vals, tango, rock and roll.*

Filma: shumë filma të huaj shiheshin fshehurazi nga televizionet e huaja sidomos nga kinematografia italiane, ku ishin sajuar antena nga më interesantet për të bërë të mundur kapjen e sinjalit: *zhurmues, kanaçe, miza (merr me miza), shirita, antenë e fshehtë* etj.

Art/letërsi: librat e huaj lexoheshin në fshehtësi dhe pëlqeheshin nga rinia. Që në atë kohë flitej për *frojdzimin, abstraksionizmin, hermetizmin*, apo dhe për *Dostojevskin, Esenin* etj.